

Në bazë të nenit 13, pika 1, të Ligjit për lojërat e fatit Nr. 04/L-080, Drejtoria e Lotarisë së Kosovës në Prishtinë, Dardania – Kurrizi 15/17, me 26.02.2013 miratoi:

RREGULLAT E LOJËS SË FATIT J O K E R

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këto Rregulla përcaktohen kushtet e përgjithshme për organizimin e lojës së fatit JOKER, si lojë plotësuese e lojës Loto 7/39, të cilën e organizon Lotaria e Kosovës.

Neni 2

Loja e fatit JOKER (në vazhdim: loja JOKER) është lojë me numra, me tërheqjen e numrit fitues gjashtëshifror përmes aparatit (mikserit), në të cilën më parë vërtetohet lartësia e fondi i fitimit në bazë të përqindjes së përcaktuar.

Neni 3

Për obligimet ndaj pjesëmarrësve, Lotaria e Kosovës (në vazhdim: organizatori) përgjigjet me të gjitha mjetet, nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me këto Rregulla. Për pagesën e fitimeve të lojës JOKER garanton Qeveria e Kosovës.

Neni 4

Këto Rregulla janë bazë ligjore për arritjen e marrëveshjes për pjesëmarrje në lojën JOKER.

Marrëveshja sipas paragrafit 1 të këtij neni lidhet në mes organizatorit në një rënë anë dhe pjesëmarrësit (lojtarit) në anën tjetër, në bazë të pranimi të kushteve të përgjithshme të parapara me këto Rregulla, sipas shprehjes së lirë të vullnetit të lojtarit, në një rënë nga mënyrat në vazhdim:

- a) duke plotësuar tiketën ndihmëse për lojën Loto 7/39 dhe Jokerin në të cilën me shenjën “X” e shënon fjalën “PO”, dhe pagesës së shumës të shënuar në vërtetim,
- b) bartjen me dorë të numrave të zgjedhur për lojën Loto 7/39 dhe numrin e Jokerit nga ana e shitësit në terminalin për pagesë dhe pagesës së shumës të shënuar në vërtetim,
- c) me zgjedhjen e rastësishme të numrave për lojën Loto 7/39 dhe numrit të Jokerit si dhe pagesës së shumës të shënuar në vërtetim.

Neni 5

Pjesëmarrës në lojën JOKER, konsiderohet personi i cili me organizatorin ka lidhur marrëveshje në bazë të nenit 4 të këtyre Rregullave, dhe si dëshmi posedon vërtetimin mbi pagesën e bërë (në vazhdim: vërtetimi), me kusht që përmbajtja e tij të jetë e regjistruar në CD dhe të jetë e deponuar në trezorin e Lotarisë së Kosovës para tërheqjes së numrave të kombinimit fitues për xhiron përkatëse.

Neni 6

Këto Rregulla i obligojnë të gjitha palët të cilat hyjnë në marrëveshje reciproke me rastin e organizimit të lojës JOKER (organizatorin, personat të cilët pranojnë pagesën-shitësit, pjesëmarrësit dhe personat të cilët që me rastin e pagesës i pranojnë këto Rregulla dhe obligohen se do të ju përmbahen).
Lotaria e Kosovës i publikon këto Rregulla në gazetën “Koha ditore” dhe mund të gjenden në çdo vendpajim.

II. MËNYRA E ORGANIZIMIT

Neni 7

Pjesëmarrësi në lojën JOKER e plotëson tiketën ndihmëse për pjesëmarrje në lojën Loto 7/39 dhe Joker, në të cilën me shenjë ”X” e shënon fjalën “PO” për pjesëmarrje në lojën Joker dhe merr vërtetimin mbi pagesën.

Tiketi ndihmës është ekskluzivisht mjet ndihmës dhe nuk mund të shërbej si dëshmi për pjesëmarrje në lojë. Dëshmi për pjesëmarrje në lojë është ekskluzivisht vërtetimi. Pjesëmarrësi është i obliguar që menjëherën pas pagesës të verifikoj se a është vërtetimi mbi pagesën komplet, gjegjësisht me të gjitha elementet e parapara me këto Rregulla, dhe mospajtimet eventuale ti reklamoj tek shitësi më së largu 15 minuta nga kryerja e pagesës, gjegjësisht marrjes së vërtetimit mbi pagesën.
Reklamacionet e mëvonshme nuk do të merren parasysh, kurse në rastin kur në vërtetim është dëmtuar kodi kontrollues dhe markeri, vërtetimi është i pavlefshëm.

Neni 8

Në lojën JOKER qëllohet numri fitues gjashtëshifror i Jokerit, i fituar me tërheqjen e gjashtë numrave të parë për xhiron përkatëse të lojës Loto 7/39.
Me rastin e pagesës së tiketës ndihmëse për pjesëmarrje në lojën JOKER në vërtetim shtypet numri serik gjashtëshifror i cili është lexuar nga tiketa ndihmëse.

Neni 9

Në lojën JOKER marrin pjesë vërtetimet e paguara për xhiron përkatëse të lojës Loto 7/39, me kusht që në vërtetim të jetë i shënuar numri i Jokerit dhe të jetë paguar loja JOKER.

Çmimin për pjesëmarrje në lojën JOKER e cakton organizatori me vendim të posaçëm.

Neni 10

Loja JOKER organizohet sipas xhirove dy herë në javë, të shtunën dhe të mërkurën. Pagesat për pjesëmarrje në lojën Joker pranohen deri në afatin që me vendim të posaçëm e cakton organizatori dhe për afatin e caktuar duhet t'i njoftoj të interesuarit. Numri i xhiros së lojës JOKER në vërtetimin mbi pagesën është identik me numrin e xhiros së lojës Loto 7/39.

Neni 11

Tiketa plotësohet lexueshëm (pastër) pa përmirsim të palejueshme, gjegjësisht ashtu që me shenjën "X" në mënyrë të pakontestueshme të jetë shënuar fjala "PO" në fushën e paraparë për zgjedhjen e lojës JOKER.

Tiketa e plotësuar në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, nuk merr pjesë në lojën JOKER dhe atëherë në vërtetimin mbi pagesën nuk shtypet numri gjashtëshifror i Joker-it. Në lojën JOKER marrin pjesë vetëm ato vërtetime mbi pagesën të cilat në vete kanë të shtypur numrin gjashtëshifror të Jokerit, me të cilën është vërtetuar pagesa shtesë për pjesëmarrje në këtë lojë.

Neni 12

Pagesa për pjesëmarrje në lojën Joker mund të pranohet edhe me parapagim për 2-8 xhiro dhe kjo bëhet atëherë kur lojëtari luan Loto me parapagim dhe shënon fjalën -"PO". Për mënyrën e organizimit dhe kushteve tjera për pjesëmarrje në lojën Joker, në tërësi vlejné dispozitat e përshtatshme nga Rregullat e lojës së fatit Loto 7/39.

I I I. MËNYRA E TËRHEQJES, VËRTETIMI I FITIMEVE DHE KOMISIONI I TËRHEQJES

Neni 13

Numri i JOKER-it për xhiron përkatëse formohet nga numrat e tërhequr për lojën Loto 7/39 për atë xhiro.

Numri i Jokerit formohet prej numrave të tërhequr për Loto, në atë mënyrë që numrin fitues të JOKER-it e përbëjnë njëshet e gjashtë numrave të parë të tërhequr, të rradhitur sipas rradhës së tërheqjes, psh: nëse është tërhequr numri 5, llogaritet si 5; nëse është tërhequr numri 27, llogaritet si 7 e kështu me rradhë.

Njishet e numrave të tërhequr, shiquar nga e majta në djathtë, paraqesin:

- numri i parë i tërhequr - qindmijëshen,
- numri i dytë i tërhequr - dhjetmijëshen,
- numri i tretë i tërhequr - mijëshen,
- numri i katërt i tërhequr - qindshen,
- numri i pestë i tërhequr - dhjetëshen,
- numri i gjashtë i tërhequr - njishen e numrit të fitues të Joker-it

Neni 14

Tërheqja e numrave për lojën JOKER bëhet njëkohësisht me tërheqjen e numrave për lojën Loto 7/39, në prani të komisionit prej tre anëtarëve, të cilët i emëron organizatori. Gjatë tërheqjes së numrave për lojën JOKER komisioni për tërheqje mban procesverbal në tri kopje në të cilin shënon të gjashtë numrat e tërhequr sipas radhës të tërhequr. Procesverbalin e nënshkruajn të tre anëtarët e Komisionit për tërheqje.

Neni 15

Në qoftë se ka jo përputhshmëri të shenjave në vërtetimin mbi pagesën dhe dokumentit i cili është deponuar në trezorin e organizatorit, gjegjësisht cilido prej elementeve mbi vërtetimin e pagesës, gjatë vërtetimit të fitimeve vlen dokumenti respektivisht shënimet e regjistruara në CD-në e deponuar në trezorin e organizatorit para fillimit të tërheqjes së numrave për xhiron përkatëse.

IV. FONDI I FITIMIT DHE SHPËRNDARJA E TIJ

Neni 16

Fondi i fitimit në lojën JOKER është 60% e shumës së përgjithshme të paguar për xhiron përkatëse dhe e vërtetuar në bazë të shënimeve në CD-në e deponuara në trezor. Organizatori mundet me një vendim të posaçëm të caktojë fondin e garantuar për numrin fitues të Joker-it.

Neni 17

Në lojën JOKER janë gjashtë lloje të fitimeve:

a). Fitimet në shuma të ndryshueshme janë fitimet shuma e të cilave caktohet ashtu që nga fondi i fitimit për xhiron përkatëse zbriten të gjitha fitimet fikse për atë xhiro dhe nga pjesa e mbetur e fondit të fitimit, 70% e përbën fondin për fitues me Joker "6" kurse 30% e përbën fondin për fitues me Joker "5" për xhiron përkatëse.

1. Fitimi Joker "6", kur pjesëmarrësi në lojën Joker ka qëlluar të 6 numrat e tërhequr të Joker-it. Fondin e tërësishëm për këtë lloj të fitimit në çdo xhiro e përbën shuma e akumuluar për Joker "6" nga xhirot e kaluara dhe fondi i fitimit për Joker "6" nga xhiroja përkatëse. Nëse në një xhiro ka më shumë se një fitues me Joker "6", fondi i tërësishëm u ndahet në shuma të barabarta të gjithë fituesve.
2. Fitimi Joker "5", kur pjesëmarrësi në lojën Joker ka qëlluar 5 numrat e fundit të tërhequr të numrit të Joker-it. Fondin e tërësishëm për këtë lloj të fitimit në çdo xhiro e përbën shuma e akumuluar për Joker "5" nga xhirot e kaluara dhe fondi i fitimit për Joker "5" nga xhiroja përkatëse. Nëse në një xhiro ka më shumë se një fitues me Joker "5", fondi i tërësishëm u ndahet në shuma të barabarta fituesve.

Nëse në xhiron përkatëse nuk ka fitues me Joker "6" shuma e fitimit për këtë lloj të fitimit bartet në xhiron e ardhshme (Jackpot). Kjo vlenë edhe për fitimin me Joker "5".

b) Fitimet në shuma fikse

3. Fitimi Joker “4” kur pjesëmarrësi në lojën Joker ka qëlluar 4 numrat e fundit të tërhequr të numrit të Joker-it. Fitimi për Joker “4” është shuma fikse 400,00 Euro.
4. Fitimi Joker “3” kur pjesëmarrësi në lojën Joker ka qëlluar 3 numrat e fundit të tërhequr të numrit të Joker-it. Fitimi për Joker “3” është shuma fikse 50,00 Euro.
5. Fitimi Joker “2” kur pjesëmarrësi në lojën Joker ka qëlluar 2 numrat e fundit të tërhequr të numrit të Joker-it. Fitimi për Joker “2” është fiks 2,50 Euro.
6. Fitimi Joker “1” kur pjesëmarrësi në lojën Joker ka qëlluar numrin e fundit të tërhequr të numrit të Jokerit. Fitimi për Joker “1” është fiks 1,00 Euro.

Fitimi i llojit më të lartë e përjashton fitimin e llojit më të ulët.

Neni 18

Fitimin ose fitimet i zbulon programi kompjuterik, kurse i vërteton Komisioni për vërtetimin dhe verifikimin e fitimeve në përbërje prej tre anëtarëve. Anëtarët e Komisionit i emëron organizatori. Komisioni fitimet i vërteton vetëm në bazë të dokumentacionit të deponuar në trezorin e organizatorit.

Komisioni është i obliguar, që më së largu në afat prej tri ditëve nga dita e tërheqjes së xhiros përkatëse, të përpiloj procesverbalin mbi shumën e paguar si dhe numrin e fitimeve sipas llojit të fitimeve dhe në bazë të këtij procesverbali përpilohet Raporti i përkohshëm dhe ai përfundimtar.

Raporti i përkohshëm për lojën JOKER, shpallet në të përditshmen “Koha ditore”, në kuadër të Raportit të përkohshëm për xhiron përkatëse të lojës Loto 7/39.

Raporti i përkohshëm përmban:

- numrin rendor të xhiros dhe datën e tërheqjes,
- kombinimin fitues për Joker,
- shumën e paguar dhe fondin e fitimit,
- numrin e fitimeve si dhe shumën e fitimeve sipas llojit,
- numrat e vërtetimeve të cilat kanë fituar fitimin Joker “6” dhe Joker “5”,
- numrin dhe shumën e fitimeve tjera,
- dërgesat që nuk kanë arritur me kohë,
- afati për pagesën e fitimeve;

Raporti i përkohshëm shpallet në të përditshmen “Koha ditore”, më së largu tri ditë nga dita e tërheqjes së xhiros përkatëse.

Raportin e përkohshëm e verifikon drejtori i Lotarisë së Kosovës.

Neni 19

Poseduesi i vërtetimit mbi pagesën i cili ka fitim në xhiron përkatëse por numri i vërtetimit të paguar ose numri i fitimeve nuk është i shpallur apo është shpallur gabim në Raportin e përkohshëm për xhiron përkatëse, ka të drejtë të bëjë reklamim.

Afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për reklamacion nga pika 1 e këtij neni është deri në ditën e tërheqjes së numrave për xhiron në vijim në ora 16.00

Kërkesa për reklamacion që ka arritur pas afatit të paraparë në këtë nen konsiderohet me afat të kaluar dhe nuk merret në shqyrtim.

Kërkesa për reklamacion dërgohet me anë të postës rekomande në adresë të Lotarisë së Kosovës, ose drejtëpërdrejt në selinë e organizatorit në Prishtinë.

Neni 20

Komisioni për vërtetimin e fitimeve i shqyrton kërkesat-reklamacionet që kanë arritur në afatin e përcaktuar sipas nenit 19 të këtyre Rregullave dhe pas procedurës së paraparë dhe vërtetimit të gjendjes faktike përpilon procesverbalin në bazë të së cilit shpallet Raporti përfundimtar për lojën JOKER.

Raporti përfundimtar shpallet më së largu 7 ditë nga dita e shpalljes së Raportit të përkohshëm për xhiron përkatëse në gazetën “Koha ditore”.

V. PAGESA E FITIMEVE

Neni 21

Pagesa e fitimeve Joker “6” dhe Joker “5” bëhet sipas Raportit përfundimtar për xhiron përkatëse në selinë e organizatorit.

Pagesa e fitimeve bëhet në afat prej 60 ditësh nga dita e shpalljes së Raportit përfundimtar. Dinamikën e pagesës së fitimit me Joker “6” e përcakton organizatori.

Pagesa e fitimeve fikse bëhet në pikat e shitjes ose në selinë e organizatorit.

Neni 22

Nëse fituesi nuk kërkon pagesën e fitimit në afatin prej 60 ditësh nga dita e shpalljes së Raportit përfundimtar, organizuesi shumë e fitimeve të papaguara do ta bartë në njërin nga xhirot e rradhës të lojës JOKER, ose do ta bartë në fondin e fitimit në lojërat tjera.

Neni 23

Gjatë tërheqjes së fitimit pjesëmarrësi është i obliguar të dorëzojë vërtetimin e rregullt. Me dorëzimin e vërtetimit, fituesi është i obliguar t’ia japë në shiqim dokumentin identifikues personit i cili bën pagesën.

Neni 24

Në rastin kur fituesi në të njëjtin vërtetim ka fitim në lojën Loto 7/39, si dhe fitim në lojën JOKER, fitimet i kërkon dhe i tërheq në të njëjtën kohë, në pajtim me afatet mbi pagesën dhe llojit të fitimit të realizuar për të dy lojërat njëkohësisht.

Neni 25

Tatimi në fitim në lojën JOKER paguhet në përputhje me ligjin.

VI. PËRGJEGJËSIA E ORGANIZATORIT

Neni 26

Organizatori nuk mban përgjegjësi kur shënimet në vërtetimin e paguar për pjesëmarrje në lojë nuk përputhen me dokumentacionin, CD-në e deponuar në trezorin e organizatorit. Organizatori nuk përgjigjet nëse shënimet në vërtetim nuk janë të plota. Organizatori nuk mban përgjegjësi në rast të vjedhjes, zjarrit, vërshimeve dhe fatkeqësive të tjera elementare, si shkak i të cilave humb ose asgjësohet vërtetimi mbi pagesën. Organizatori nuk përgjigjet për vërtetimet mbi pagesën, të cilat i kanë humbur shitësit, pjesëmarrësit apo ndonjë personi të tretë.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËFUNDIMTARE

Neni 27

Organizatori është i obliguar që t'i ruajë shënimet e vërtetimeve në CD më së paku një vit nga dita e tërheqjes së xhiros përkatëse, me përjashtim në rastet kur është hapur procedura gjyqësore për realizimin e së drejtës në fitim nga pjesëmarrja në lojën JOKER. Në këtë rast organizatori është i obliguar që t'i ruajë shënimet e vërtetimeve në CD deri në përfundimin e procedurës gjyqësore. Shënimet e pagesave në lojën JOKER ruhen së bashku me shënimet e lojës Loto 7/39.

Neni 28

Për mënyrën e organizimit, përpunimit dhe kushteve tjera për pjesëmarrje në lojën JOKER, e të cilat nuk janë të rregulluara me këto Rregulla, në tërësi vlejné dispozitat e Rregullave të lojës së fatit Loto 7/39.

Neni 29

Për zgjidhjen e kontesteve që dalin nga pjesëmarrja në lojën JOKER është kompetente Gjykata Komunale në Prishtinë.

Neni 30

Këto Rregulla hyjnë në fuqi ditën e shpalljes në gazetën ditore "Koha Ditore".

Drejtor
Bashkim Sllamniku